Duke u bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja (d), të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", e në mbështetje të nenit 8 paragrafi 2 pika 2.3 lidhur me nenin 143 të Ligjit Nr. 03/l-233 për mbrojtjen e natyrës, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 85/2010", e konform nenit 29 dhe 40, të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë, në mbledhjen e mbajtur me datën, 27.04.2023 miratoi këtë:

V E N D I M
Për ndryshim-plotësimin e vendimit 01-Nr-56, të datës 15.03.2007

Neni 1

Me këtë vendim ndryshohet-plotësohet vendimit, 01-Nr-56 i datës 15.03.2007 për mbrojtjen e vlerave të natyrës në territorin e Komunës së Suharekës, me qellim të zëvendësimit të monumenteve të natyrës.

1.1 Monumentet e mbrojtura të natyrës të cekur në pikën 4. Trungjet e dushkut (Quercus sp.) në varrezat e fshatit Grejkoc, në pikën 5. Trungu i Plepit (Populus sp.) në shatin Reçan dhe pika 5. Burimi i ujit mineral në fshatin Reçan, të vendimit 01-Nr-56, të datës 15.03.2007, largohen nga lista e zonave të mbrojtura për shkak të dëmtimeve, të konstatuara me raportin me Nr.5435 të datës 01.12.2021 të Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës.

1.2 Vlerat e natyrës të evidentuar si më poshtë futen në listën e zonave të mbrojtura të natyrës në territorin e Komunës së Suharekës, me rekomandimin e cekur në raportin me Nr.5435 të datës 01.12.2021 të Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës.

Emërtimi i zonës		Vendi	Shtrirja gjeografike			Kategoria që merret për mbrojtje
			Kordinata X	Kordinata Y	Sipërfaqja	
1.	Trungu i dushkut në Suharekë	Suharekë	4690727.3 Ose sipas K. gjeografike 42.356	7486866.9 Ose sipas K. gjeografike 20.841	18850.05m^2	Monument natyre (botanik) III
2.	Trungu i dushkut në Krushic të Poshtme (varrezat e fshatit)	Krushic e Poshtme	4691693.0 Ose sipas K. gjeografike 42.365	7492287.22 Ose sipas K. gjeografike 20.906	500.00m^2	Monument natyre (botanik) III
3.	Trungu i dushkut në Bllacë (varrezat e fshatit)	Bllacë	4697443.01 Ose sipas K. gjeografike 42.417	7488175.89 Ose sipas K. gjeografike 20.856	500.00m^2	Monument natyre (botanik) III

Neni 2

Ndërsa pjesët tjera kompletë të vendimit bazë me numër 01-Nr-56 i datës 15.03.2007, mbesin të pa ndryshuara.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për shërbime publike, mjedis dhe emergjencë e Komunës së Suharekës.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008" dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve dhe faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNSËNËSUHAREKË

01-Nr-016-27355
Me datë 27.04.2023

REPUBLIKA E KOSOVËS KUVENDI I KOMUNËS SUHAREKË REPUBLIKA KOSOVA SKUPŠTINA OPŠTINA SUVA REKA REPUBLIC OF KOSOVA THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA

Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec.Bexhet KUÇI